SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE ORGANIZATES JOFITIMPRURESE
**Fondacioni Down Syndrome Albania – DSA**

**Per ushtrimin financiar te mbyllur me 31 Dhjetor 2023**

***1. Informacion i pergjithshem***

**Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA)**, person juridik i regjistruar me vendim gjykate Nr. 429, datë 09.09.2013 dhe me NIPT L32117451M, me seli ligjore të regjistruar me adresë: Rruga Hajredin Kumbaro, Sauk, Tiranë, Shqipëri, përfaqësohet nga Drejtore Ekzekutive, Znj. Emanuela Zaimi. Veprimtaria e Fondacionit rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.8788 "Per organizatat Jofitimprurese" i ndryshuar, Kuadri ligjor fiskal ne teresi dhe nga statusi i saj.

Aktiviteti kryesor i organizates: Eshte intergrimi i plote ne shoqeri, pavaresia dhe cilesa e larte e jeteses per personat me Sindrome Down, dhe persona te tjere me aftesi te kufizuara intelektuale ne Shqiperi.

Ne 31 Dhjetor, 2023 Down Syndrome Albania ka pasur 21 punonjes,

***2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare***

(a) Deklarata e Pajtueshmerise

Pasqyrat financiare jane perqatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara (SKK) dhe Ligjit Nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ne vecanti sipas standartit per OJF.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane perqatitur mbi bazen e parimit te kostos historike.

(c) Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat financiare te Organizates perqatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se organizata do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane perqatitur ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e organizates.

3. Politikat kontabet

(a) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit

ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte, Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.
Kursi i kernbimit i monedhave te huaja me 31 Dhjetor 2022 eshte i detajuar si me poshte:
Kursi i kembimit (**burimi**. Banka e Shqiperise, website zyrtar).

| | |
|---|---|
| Euro/Lek | 103.88 |
| USD/Lek | 93.94 |
| GBP/Lek | 112.10 |

(b) Mjetet monetare
Mjetet monetare perfshijne arken, lloqarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, mjetet monetare perfshijne depozitat me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

(c) Llogarite e arketueshme
Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se organizata nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

(d) Llogarite e pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

(e) Hua te marra dhe te dhena
Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht dhe mbahen ne vazhdim me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqvren e te ardhurave dhe shpenzimeve cdo diference midis kostos dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv. lnteresat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

(f) Vlera e drejte
Vlerat e drejta te perllogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per t'u paguar dhe huave, perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

(g) Kapitali themeltar
Organizate Jofitimprurese – Nuk Ka.

(h) Aktivet afatgjate materiale
(i) Njohja dhe matja
Te gjitha aktivet afatgjata materiate paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vetendertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte,

cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kostot e cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate nderitimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi i tij, nga ku aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material, kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mepasshme
Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe organizata do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatagjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi
Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur rnetoden e vleres se mbetur te amorizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qera amorizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qerase dhe jetes se dobishme te aktivit.
Normat e amortizimit jane te paraqitura si me poshte:

| | |
|---|---|
| • Ndertesa | 5% |
| • lnstalime&Makineri&Pajisje | |
| • Mjete transporti | 20% |
| • Pajisje informatike | 25% |
| • Mobilje,Orendi zyrash | 20% |

(iv) Cregjistrimi
Nje ze i aktiveve afatgjata materiale crregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorirnit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operative te vitit.

(i) Te ardhurat
Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike do te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te arketuar ose te arketueshme qe merr parasysh shumen e cfaredo zbritje tregtare, zbritjet per shlyerje te menjehershme dhe zbritjet e bera per sasi te blere.

j) Te ardhurat e tjera te shfrytezimit
Te ardhurat e tjera te shfrytezimit paraqesin te ardhurat qe perfitohen jo rregullisht gjate rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike duke perfshire, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivleresimet e aktiveve afatgjate te investuara dhe fitim/humbjet te cilat vijne nga ndryshimi i kursit te kembimit pervec diferencave te kembimit qe lidhen me veprimtarite financiare dhe investuese.

(k) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interest efektiv.

Shpenzime financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vlere e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

(l) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate periudhes. Perqindja e tatim fitimit ne fuqi gjate vitit 2022 ishte 15%.

Organizata nuk ka aktivitet ose pjese aktiviteti te tatushme.

(m) Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura percaktohen kur nje pale kontrollohet nga pala tieter, ose ka ndikim te rendesishem ne vendimet e biznesit apo vendimet financiare te pales tjeter, Per qellime te paraqitjes se pasqyrave financiare, drejtimi i organizates konsiderohen si pale te lidhura.

(n) Te tjera

Menyra e likuidimit dhe arketimit. Shoqata operon nepermjet llogarive bankare dhe parave ne dore ne arketimin e te drejtave dhe likuidimin e detyrimeve.

SHENIME MBI ZERAT E LLOGARIVE NE PASQYRAT FINANCIARE AKTIVET

Vijon:

FOND. "DOWN SYNDROME ALBANIA"
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
31 Dhjetor 2023

| | AKTIVET | Shenime | Viti 2023 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|
| I | **AKTIVET AFATSHKURTRA** | | **47,772,971** | **80,335,620** |
| | **1 Aktive monetare** | | **22,012,675** | **31,798,771** |
| | >Banka | | 21,801,163 | 31,243,138 |
| | >Arka | | 211,512 | 555,633 |
| | >Hua dhe letra me vlere | | - | - |
| | **2 Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregim** | | - | - |
| | **3 Aktive te tjera financiare afatshkurtra** | | **2,432,164** | **2,330,294** |
| | >Kontribute te arketueshme | | 2,260,994 | 2,211,040 |
| | >Debitore, kreditor te tjere | | 171,170 | 119,254 |
| | >Te drejta dhe interesi i arketueshem | | | |
| | >Parapagime te dhena | | | |
| | >Investime te tjera | | - | - |
| | **4 Inventari** | | **2,695,992** | **2,696,575** |
| | >Lendet e para | | 2,695,992 | 2,695,992 |
| | >Produkte te gateshme | | - | - |
| | >Mallra per rishitje | | - | 583 |
| | >Inventare te Imeta (baze didaktike etj) | | | |
| | **5 Aktivet biologjike afateshkurtra** | | - | - |
| | **6 Aktivet afateshkurtera te mbajtura per shitje** | | - | - |
| | **7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | | **20,632,140** | **43,509,980** |
| | >Shpenzime te periudhave te ardheshme | | 20,632,140 | 43,509,980 |
| II | **AKTIVET AFATGJATA** | | **8,380,473** | **7,381,691** |
| | **1 Investimet financiare afatgjata** | | - | - |
| | >Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje | | - | - |
| | > | | - | - |
| | > | | - | - |
| | **2 Aktive afatgjata materiale** | | **7,061,239** | **7,381,691** |
| | >Toka dhe Nderttesa | | 3,169,538 | 3,375,129 |
| | >Makineri dhe pajisje | | 3,891,701 | 4,006,562 |
| | >Aktive te tjera afatgjata materiale ( me vl. kontab.) | | | |
| | **3 Aktivet afatgjate ne proces** | | | |
| | **4 Aktivet biologjike afatgjata** | | - | - |
| | **5 Aktivet afatgjata jomateriale** | | 1,319,234 | - |
| | **7 Aktive te tjera afatgjata** | | - | - |
| | **TOTALI I AKTIVEVE ( I +II )** | | **56,153,444** | **87,717,311** |

| Nr. | DETYRIMET DHE AKTIVET NETO | Shenime | Viti 2023 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|---|
| I | **DETYRIMET AFATSHKURTERA** | | **11,206,848** | **54,093,635** |
| | **1 Derivativet** | | - | - |
| | **2 Huamarrjet** | | - | - |
| | >Llogari bankare te zbuluara | | - | - |
| | >Huamarrjet nga Bankat | | - | - |
| | >Huamarrjet nga te tretet | | - | - |
| | **3 Huat dhe parapagimet** | | **1,985,837** | **2,120,480** |
| | >Te pagueshme ndaj furnitoreve | | 1,162,840 | 1,562,214 |
| | >Te pagueshme ndaj punonjesve | | - | - |
| | >Detyrimet ndaj sigurimeve shoqerore | | 422,630 | 330,462 |
| | >Detyrime te tjera tatimore | | 400,367 | 227,804 |
| | >Kontribute te marra ne avance | | - | - |
| | >Debitore e kreditore te tjere | | - | - |
| | | | | |
| | **4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | | **9,221,011** | **51,973,155** |
| | **5 Provizionet afatshkurtra** | | - | - |
| II | **DETYRIMET AFATGJATA** | | **11,322,920** | - |
| | **1 Huate afatgjata** | | - | - |
| | >Huat nga banka | | - | - |
| | >Detyrime nga qeraja financiare | | - | - |
| | >Huat nga te trete | | - | - |
| | **2 Huamarrje te tjera afatgjata** | | - | - |
| | >Premtime te kushtezuara per te dhene | | - | - |
| | **3 Grantet dhe te ardhurat e shtyra** | | 11,322,920 | - |
| | **4 Provizione afategjata** | | - | - |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE ( I + II )** | | **22,529,768** | **54,093,635** |
| | | | | |
| III | **AKTIVET NETO** | | **33,623,676** | **33,623,676** |
| | **1 Aktive te kufizuara** | | - | - |
| | a) Toke ose vepra arti te dhuruara per t'u perdorur per qellime specifike me percaktimin qe te ruhen apo te mos shiten | | - | - |
| | b) Aktive te dhuruara me qellimin per t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime te perhershme te ardhurash | | - | - |
| | **2 Aktive te pakufizuara** | | 33,623,676 | 33,623,676 |
| | **TOTALI I AKTIVEVE NETO DHE DETYRIMET** | | **56,153,444** | **87,717,311** |

## A - PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCES)
**( Bazuar ne klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyres )**

| Nr. | Pershkrimi I Elementeve | Viti 2023 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|
| | | | |
| 1 | Ndryshimi ne aktivet neto te pakufizuara: | - | - |
| | | | |
| 2 | **Te ardhurat:** | | |
| i | Te ardhura nga Projektet | 28,863,346 | 25,685,449 |
| ii | Te ardhura nga dhurime/sponsorizimi | 5,328,204 | 8,283,466 |
| iii | Te ardhura nga shitja e produkteve promocionale | 2,296,788 | 3,303,901 |
| iv | Te ardhura nga terapite dhe veresimet | 4,194,500 | 6,307,500 |
| v | Te ardhura nga rivleresimi/kursi i kembimit | 23,124 | 126,771 |
| vi | Te ardhura nga rivleresimi/shitja e aseteve | | 301,425 |
| | **Totali i te ardhurave nga Aktivet Neto te Pakufizuara** | **40,705,962** | **44,008,512** |
| | | | |
| | **Aktive Neto te cliruara nga kufizimet:** | | |
| a) | Realizimi i kufizimeve te programit | | |
| b) | Realizimi i kufizimeve per blerjen e paisjeve | | |
| c) | Perfundimi i kufizimit te afatit | | |
| | **Totali i Aktiveve Neto te cliruara nga kufizimet** | - | - |
| | | | |
| | **TOTALI I TE ARDHURAVE NGA AKTIVET NETO TE PAKUFIZUARA** | **40,705,962** | **44,008,512** |
| | | | |
| | **SHPENZIMET PER AKTIVITETET** | **- 15,900,848** | **- 13,334,084** |
| a) | Shpenzime per aktivitetet e ndryshme dhe rritje fondesh | - 9,754,677 | - 7,229,395 |
| b) | Te tjera | - 6,146,171 | - 6,104,689 |
| | **Shpenzime administrimi:** | **- 24,805,114** | **- 22,377,402** |
| a) | Kosto e punes -pagat e personelit -shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore | - 23,423,575 | - 19,543,018 |
| b) | Amortizimet dhe zhvleresimet | - 1,260,370 | - 1,554,644 |
| c) | Shpenzime te tjera(taksa etj) | - | - |
| d) | Te ardhurat dhe shpenzimet financiare ( interesa, komisione) | - 121,169 | - 161,558 |
| e) | Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit | | - 1,118,182 |
| | **Totali I shpenzimeve** | **- 40,705,962** | **- 35,711,486** |
| | | | |
| | **Rritja/Renia ne Aktivet Neto te Pakufizuara ( A)** | - | **8,297,025** |
| | | | |
| | Ndryshimi ne aktivet neto te kufizuara: | - | - |
| | Kontributet | - | - |
| | Te ardhura nga investime afatgjata | - | - |
| | Fitimi i realizuar dhe i parealizuar nga investimet afatgjata | - | - |
| | Aktivet neto te cliruara nga kufizimet ( me minus) | - | - |
| | Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor | | |
| | **Rritja/Renia ne Aktivet Neto Perkohesisht te Kufizuara ( B)** | - | - |
| | | | |
| | | | |
| | Aktivet neto ne fillim te vitit 2022, 2021 | **33,623,676** | **25,326,651** |
| | Aktive neto ne fund te vitit 2022, 2021 | **33,623,676** | **33,623,676** |

***Ngjarjet pas bilancit***

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

Tirane me 30 Qershor, 2024

Drejtoreshe Ekzekutive

NIPT: L32117451M
Down Syndrome Albania

Emanuela Zaimi

Hartoi

Altin Allmuca

**Lic. profesionale 893, date 27.11.2002**

**Nuis. L52312001F**